

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË 1

Direktiva 92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, amenduar, Nr. Celex 01992L0043-20070101, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 206, datë 22.7.1992.		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”. Përputhshmëri e plotë				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime

Neni 1, pika (i)	(i) <i>statusi ruajtës i një lloji</i> është tërësia e influencave që veprojnë mbi specien në fjalë që mund të ndikojë në shpërndarjen dhe sasinë afatgjatë të masës së saj brenda territorit të parashikuar në Nenin 2; Statusi ruajtës do të marret si “i favorshëm” kur: - të dhënat mbi dinamikën e masës së species në fjalë tregojnë që ajo funksionon si një komponent praktik i habitatit të saj natyror në komponent praktik i habitatit të saj natyror në kuadrin afatgjatë, dhe - variacioni natyror i llojit as nuk zvogëlohet as nuk mund të zvogëlohet në një të ardhme të parashikueshme, dhe - ka, dhe do të vazhdojë të ekzistojë një habitat mjaftueshmërisht i madh për të mbajtur masën e saj në kuadrin afatgjatë kohor.	Lidhur me nenin 2 që përmendet te neni 1 (i) i Direktivës 92/43/EEC, informojmë se ligji 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar” ka përafruar plotësisht nenin 2 (pikat 2, dhe 3 të tij, pasi pika 1 flet	Neni 4, pika 3	3. Pas pikës 9, shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje: “9/1 “Status i favorshëm ruajtjeje për një lloj” është kur: a) të dhënat dinamike të popullatës për një lloj me interes tregojnë që ai ngelet për një kohë afatgjatë një përbërës i vlefshëm dhe i aftë i habitateve të tij natyrore; b) përhapja natyrore e llojeve nuk është pakësuar dhe nuk ka gjasa të pakësohet në të ardhmen e afërt; c) gjendet dhe me shumë gjasa do të vazhdojë të jetë një habitat i përshtatshëm, nga ana e përmasave, për të mbajtur popullatën për një kohë të gjatë.”.	E plotë	
------------------------------------	---	--	----------------------------------	---	-----------------------	--

		posacerisht për territorin e vendeve të BE), shprehur kjo në vetë ligjin nr. 68/2014				
--	--	--	--	--	--	--

Neni 1, pika (j)	(j) zonë është sipërfaqja e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi;		Neni 4, pika 2/1	2/1. "Zonë" është një zonë e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi	E plotë	
Neni 6, pika 1-4	Për zonat e veçanta të ruajtjes, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat ruajtëse të nevojshme duke përfshirë, nëse është e nevojshme, plane menaxhuese të përshtatshme të hartuara për zonat ose të integruara në plane të tjera zhvillimi, dhe masa të përshtatshme statutore, administrative ose kontraktuale të cilat përkojnë me kërkesat ekologjike të tipeve të habitateve të Shtojcës I dhe të specieve të Shtojcës II të pranishme në këto zona. 2. Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të mënjeluar në zonat e vecanta të ruajtjes shkatërrimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të specieve si dhe		Neni 7	Masat e mbrojtjes për zonat me interes për komunitetin europian 1. Me shpalljen e një zone si zonë me rëndësi për komunitetin, në të do të zbatohen masat specifike të ruajtjes në përputhje me planet e menaxhimit, planet zhvillimore dhe detyrimet ligjore ose kontraktuale, që korrespondojnë me kërkesat ekologjike të tipeve të habitatit natyror në Shtojcën I dhe llojeve në Shtojcën II të	E plotë	

	shqetësimin e specieve për të cilat këto zona janë përcaktuar, në rastet kur ky shqetësim është dukshëm i lidhur me objektivat e kësaj Direktive. 3. Çdo plan ose projekt i lidhur jo drejtpërdrejt me menaxhimin e zonës ose që nuk është i nevojshëm për menaxhimin e zonës, por që mund të ketë efekt të dukshëm më pas, ose individualisht ose i kombinuar me plane ose projekte të tjera, duhet të jetë subjekt për vlerësimin e duhur të ndikimeve të tij mbi zonat në pikëpamjen e objektivave ruajtëse të tyre. Nën dritën e konkluzioneve të vlerësimit të ndikimeve mbi zonë dhe në bazë të dispozitave të paragrafit 4, autoritetet kombëtare kompetente duhet të bien dakort me planin ose projektin vetëm pasi të kenë siguruar që ai nuk do të ndikojë negativisht mbi integritetin e zonës në fjalë dhe pasi të ketë marrë opinionin e publikut nëse një gjë e tillë është e nevojshme. 4. Pavarësisht nga vlerësimi negativ i ndikimeve mbi zonë			Direktivës së Habitaveve. 2. Çdo plan ose projekt që nuk lidhet drejtpërdrejt, por mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën me rëndësi për komunitetin europian, i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Bazuar në raportin e vlerësimit të ndikimit për zonën dhe llojet, autoritetet kompetente miratojnë planin ose projektin, vetëm pasi të konstatohet se ai nuk do të ndikojë negativisht në integritetin e zonës në fjalë dhe vetëm pas marrjes së mendimit të publikut të gjerë. 3. Në rastet kur një plan apo projekt duhet të realizohet për arsye të interesit publik, pavarësisht ndikimit negativ në zonën dhe llojet, dhe në mungesë të zgjidhjeve alternative, duhet të miratohen masa kompensuese, për të siguruar koherencën e përgjithshme të rrjetit të zonave me rëndësi për komunitetin europian. Komisioni informohet		
--	---	--	--	---	--	--

	dhe në mungesë të zgjidhjeve alternative, duhet të ndërmerret një plan ose projekt për arsye urgjence të interesit të publikut, duke përfshirë ato të natyrës sociale ose ekonomike, por Shteti Anëtar duhet të marrë të gjitha masat kompensuese të nevojshme për të siguruar respektimin e koherencës së përgjithshme me rrjetin “Natura 2000”. Shteti Anëtar duhet të informojë Komisionin për masat kompensuese të adoptuara.			për masat kompensuese të miratuara.		

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË 2

Direktiva 2009/147/EC “Për konservimin e shpendëve të egër” Nr. Celex 32009L0147, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20, datë 26.1.2010, faqe 7-25.		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10006, date, 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”. Përputhshmëri e pjesshme				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime

Neni 1 pika 1	Kjo Direktivë lidhet me konservimin e të gjitha llojeve të shpendëve që fluturojnë natyrshëm në vendet e territorit të Vendeve Anëtare të Bashkimit Europian, në të cilat ky Traktat aplikohet. Ai mbulon mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e këtyre llojve dhe përcakton rregulla për përdorimin e tyre.		Neni 3 pika 1	Në nenin 1, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme: 1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Ky ligj ka për qëllim konservimin e faunës së egër, mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e saj, me synimin për të konservuar llojet, popullatat, habitatet ku kjo faunë e egër jeton, si dhe për të plotësuar kërkesat e tyre për ushqim, strehim dhe shumim duke siguruar në të njëjtën kohë dhe rrugët e saj të shtegtimimit”.	E plotë	
Neni 2	Vëndet Anëtare do të ndërmarrin masat e nevojshme për të mirëmbajtur popullatat e specieve të cilave i referohemi në Nenin 1, në një nivel që korrespondon në veçanti me kërkesat ekologjike, shkencore dhe kulturore, ndërkohë që merren në konsideratë kërkesat ekonomike dhe rikrijuese, ose për të adoptuar popullatat e këtyre specieve në atë nivel.		Neni 13, pika 1 e ligjit nr. 10006, date, 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar.	Neni 13 Ruajtja dhe përshtatja 1. Ruajtja dhe përshtatja e popullatave të shpendëve të egër dhe shtegtarë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndihmohen duke u siguruar një status të favorshëm ruajtjeje ekologjike, shkencore dhe kulturore, sipas të cilit ndalohet: a) vrasja ose kapja e qëllimshme e tyre me çdo metodë;	E pjesshme	

Neni 3 pika 1	1. Në këndvështrimin e kërkesave që referohen në Nenin 2, Vëndet Anëtare do të ndërmarrin masat e nevojshme për të ruajtur, mirëmbajtur ose për të rikrijuar një shumllojshmëri të mjaftueshme dhe zonat e vendbanimeve për të gjitha llojet e shpendëve që referohen në Nenin 1.	Neni 2 i kësaj Direktive 2009/147 është transpozuar plotësisht në nenin 13 pika 1 e ligjit nr. 10006, datë	Neni 3 pika 2	b) dëmtimi i qëllimshëm, zhvendosja e shkatërrimi i çerdheve dhe i vezëve të tyre; c) marrja dhe mbajtja e vezëve nga gjendja e egër edhe nëse këto vezë janë bosh; ç) shqetësimi i qëllimshëm i shpendëve, veçanërisht gjatë periudhës së shumimit dhe rritjes së të vegjëleve; d) mbajtja në robëri dhe gjuetia e llojeve të ndaluara me akt normativ; dh) mbajtja, transporti, shitja dhe ofertimi për shitje i shpendëve të gjallë apo të ngordhur. 2. Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: 3. Përmes këtij ligji synohet: a) ruajtja ose rivendosja në gjendje të favorshme të habitateve natyrore dhe llojeve të faunës së egër me interes për komunitetin europian; b) sigurimi i vlerësimit të gjendjes së biodiversitetit në Shqipëri dhe të mekanizmave	E pjesshme	
-----------------------------	--	---	-----------------------------	--	--------------------------	--

		23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”.		për monitorimin e kësaj gjendje; c) krijimi i një sistemi, me qëllim mbrojtjen dhe konservimin afatgjatë të karakteristikave të cilat do të shërbejnë si baze për përcaktimin e zonave potenciale për t’u shpallur zona të mbrojtura.		
--	--	---	--	---	--	--